L I G J
Nr. 9161, datë 18.12.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 4 shtohet shkronja "i" me këtë përmbajtje:
"i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.".

Neni 2

Në fund të nenit 8 shtohen shkronjat "f" dhe "g" me këtë përmbajtje:
"f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër;
g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 3

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1
Të ardhura të përjashtuara

Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat vetjake:
1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve.
3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publikë.
5. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
6. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.".

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:
a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, si dhe të gjitha shpërblimet ose të ardhurat e tjera që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatohen me 10 për qind.”.

b) Pika 3 shfuqizohet.

Neni 5

Në fund të nenit 10 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 6

Në nenin 14 shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“e) mosdorëzimi në kohë i deklaratës për tatimin mbi të ardhurat vetjake të mbajtura në burim sipas nenit 10 dhe mospagimi në kohë i tatimit të kërkuar;

ë) deklarimi më i ulët i të ardhurave vetjake për t’u paguar;

f) mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat vetjake të punëmarrësve, por mospagimi i tyre në organin tatimor.”.

Neni 7

Në nenin 15 shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“d) për rastet e shkeljeve të dispozitave, të parashikuara në shkronjën “e” të nenit 14, punëdhënësi gjobitet me 10 për qind të shumës së tatimit të mbajtur në burim, të deklaruar me vonesë, dhe jo më pak se 10 mijë lekë për çdo muaj ose pjesë të muajit që vijon pas datës që duhet të ishte bërë deklarimi;

dh) për rastet e shkeljeve të dispozitave të parashikuara në shkronjën “ë” të nenit 14, punëdhënësi gjobitet me 100 për qind të shumës së detyrimeve që nuk janë paguar;

e) në rastet e shkeljes së dispozitave të parashikuara në shkronjën “f” të nenit 14, punëdhënësi gjobitet me 100 për qind të shumës së papaguar të kontributeve. Kur këto kontribute nuk i janë paguar organit tatimor edhe pas një periudhe prej 3 muajsh nga data e përcaktuar në ligjin përkatës, atëherë mbi punëdhënësin bëhet kallëzim penal.”.

Neni 8

Në fund të nenit 20 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe i lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.”.

Neni 9

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;”.

2. Shkronja “k” ndryshohet si më poshtë:

“k) shpenzimet për dhurata;”.

3. Pas shkronjës “l” shtohet shkronja “ll” me këtë përmbajtje:

“ll) shpenzimet për shërbime teknike, konsulencë dhe të menaxhimit të faturuara nga persona të tretë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi.”.

Neni 10

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 29
Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit

Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Për efekte fiskale, të dhënat e dokumenteve të mësipërme quhen të pranuara, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 të këtij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

3. Çdo parapagim i rezultuar më shumë se tatimi i llogaritur në bazë të pikës 2 të këtij neni, njihet nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore të prapambetura ose për pagesën e detyrimeve tatimore të ardhshme ose, me kërkesën e tatimpaguesit, i rikthehet atij nga organet tatimore brenda 60 ditëve nga marrja e deklaratës tatimore.".

Neni 11

Shkronja "a" e pikës 2 të nenit 32/1 ndryshohet si më poshtë:

"a) ambulantët në fushën e tregtisë;".

Pas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 32/1 shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) ata që realizojnë një qarkullim vjetor prej më pak se 3 milionë lekë në fushën e shërbimeve.".

Neni 12

Në fund të nenit 32/5 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Libri i shitjeve (qarkullimit) dhe fatura e thjeshtë tatimore prodhohen dhe shpërndahen nga organet tatimore, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave.".

Neni 13

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 33
Mbajtja e tatimit në burim

1. Të gjithë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë, tregtarë, që janë rezidentë shqiptarë, për qëllime tatimore, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse, mbajnë në burim tatimin në masën 10 për qind për pagesat e mëposhtme:

a) dividentët;

b) ndarjet e fitimit;

c) interesat, përveç interesave të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë të emetuara nga Këshilli i Ministrave para datës 1 janar 1999;

ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe të pronësisë intelektuale;

d) pagesat për shërbimet teknike;

dh) pagesat për menaxhim e për pjesëmarrje në këshillat drejtues;

e) pagesat për ndërtim, instalim, montim ose punë mbikëqyrëse;

ë) pagesat për qiratë;

f) pagesat për argëtues, artistë ose sportistë, në një shfaqje ose prezantim në Republikën e Shqipërisë dhe pagesa të tilla, bërë personave juridikë ose ortakërive, të cilët punësojnë argëtues, artistë ose sportistë ose ndërmjetësojnë shfaqje a prezantime të tilla;

g) çdo pagesë tjetër e bërë për shërbime, jo për mallra, që nuk përfshihet në pikat e mësipërme.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet vetëm kur pagesat u bëhen personave, të cilët nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin ose i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, si edhe kur pagesat u bëhen personave jorezidentë shqiptarë.

3. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe ndaj jorezidentëve, për pagesa të tilla, të lindura nga një person me seli të përhershme që ai mban në Republikën e Shqipërisë.

4. Pika 1 e këtij neni nuk do të zbatohet ndaj pagesave që i bëhen personave jorezidentë shqiptarë për shërbime të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve dhe të mallrave.”.

Neni 14

Neni 34 shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4078, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Pasqyra nr.3

TARIFAT E TATIMIT TË THJESHTUAR MBI TË ARDHURAT

Nr.	Tipi (lloji) i biznesit	Tarifa e tatimit të thjeshtuar
1.	Shitje me pakicë	4 për qind
2.	Prodhim	4 për qind
3.	Shërbime	5 për qind
4.	Profesione të lira	5 për qind